

**AKT - THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**« ONLYTECH » shpk**

Sot me date 12 Mars 2024 ( dymije e njetzet e kater ), ditën e marte, unë ortaku i vetëm i shoqërisë :

- 1. GAZËMIR META**, me atësi Riza dhe amësi Sheje i datelindjes 11.04.1971, lindur në Gradishtë, Lushnjë dhe banues në Babunjë, Lushnjë - Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, me numër personal H10411028P, mbajtes i leternjoftimit nr. 035239824.

bazuar në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,

**Vendosa**

Krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar « ONLYTECH » shpk, në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “.

**NENI 1**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

- Shoqëria Tregtare do të quhet « ONLYTECH » shpk.

**NENI 2**

**FORMA E SHOQERISE**

- Shoqëria « ONLYTECH » shpk është e llojit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me një ortak të vetëm, e krijuar dhe zotëruar nga unë ortak i vetëm GAZËMIR META.

**NENI 3**

**QENDRA ( SELIA ) E SHOQERISE**

- Shoqëria « ONLYTECH » shpk do të ketë qendrën ( selinë ) e saj në adresën: Çlirim, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Fier, Qarku Fier, zona kadastrale nr. 1414, pasuria nr. 38/24-N2.
- Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë.
- Me vendim të ortakut të vetëm Shoqëria mund të hapë dege dhe/ose zyra të tjera përfaqësimi, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**NENI 4**

**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE**

- Shoqëria « ONLYTECH » shpk do të veprojë për një periudhë kohore me shumë se 10 vjet.
- Me vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë ky afat mund të jete më i shkurtër apo mund të zgjatet më tej.

**NENI 5**

**REGJIMI JURIDIK**



- Ne te gjithë territorin e saj ne Republikën e Shqipërisë, Shoqëria do të udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.
- Shoqëria gezon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
- Per evidentimin e veprimtarise se Shoqërisë do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi dhe kerkesat e pergjithshme te kontabilitetit, sic sqarohet me hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqërisë.
- Shoqëria gezon afirmimin ligjor qe nga dita e rregjistrimit te saj ne Q.K.B.

## **NENI 6** **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

- Objekti i veprimtarise se shoqërisë do te jete :
  - Tregtim me shumice dhe pakice i materialeve, pajisjeve dhe aksesoreve te ndryshme elektrike; import dhe eksport i tyre.
  - Tregtim me shumice dhe pakice i: mallrave te ndryshem industriale; pajisjeve elektronike dhe elektroshtepijake; impianteve te ndryshem per ngrohjen/ftohjen e ambienteve; paneleve diellore per perdorim familjar e me gjere; materialeve te ndertimit; materialeve dhe pajisjeve hidraulike; mallrave te tjere te tregtueshem. Import – eksport te tyre.
  - Projektimi dhe zbatimi i punimeve te ndertimit, rikonstruksioneve, mbikqyrje-kolaudim punimesh zbatimi dhe montimi ne godina banimi civile, industriale, bujqesore, turistike, shoqërore, rruge ura e vepra arti, si dhe punime te te gjitha llojeve ne fushen e ndertimit e montimit dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to; Punime dheu, murature betoni e betonarmeje ; Kryerja e sherbimeve dhe punimeve te ndryshme, brenda dhe jashte territorit te Republikës se Shqipërisë ; Eksport-import dhe tregtim me shumice e pakice i te gjitha llojeve te materialeve e paisjeve te ndertimit, hidrosanitare, elektrike etj.
- Me vendim te ortakut te vetem Shoqëria mund te shtoje apo pakesoje ne cdo kohe objektin e veprimtarise se saj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

## **NENI 7** **KAPITALI I SHOQËRISË**

- Kapitali fillestar i Shoqërisë eshte 500.000 ( peseqind mije ) leke, i barabarte me 1 ( nje ) kuote me vleren prej 500.000 lekesh.
- Kjo kuote eshte teresisht prone e Ortakut te Vetem te Shoqërisë dhe vlera e kapitalit do te depozitohet ne njerën prej Bankave te Nivelit te Dytë si kapital themeltar i Shoqërisë « ONLYTECH » shpk, pas rregjistrimit te shoqërisë ne QKB.
- Kapitali i shoqërisë do te rritet krahas ecurisë se saj ekonomike, financiare si dhe te vendimeve qe do te marr une Ortaku i Vetem per ta rritur ate ne te ardhmen.
- Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te shoqërisë si dhe transferimi i kuotave te shoqërisë do te behet ne perputhje me me legjislacionin perkates qe rregullon veprimtarine e kesaj shoqërie tregtare si dhe me dispozitat perkatese te statutit te saj.
- Ne rast vdekjeje te Ortakut te Vetem te Shoqërisë, pasuria u kalon trashëgimtareve te tij, sipas legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë.



## **Neni 8** **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**



- Fillimisht shoqeria do te udhehiqet, administrohet dhe drejtohet nga Administratori i shoqerise **MIGUEL VRENOZI**, me atesi Rrapi dhe amesi Lavdie, i datelindjes 17.07.1988, lindur dhe banues ne Clirim, Fier - Shqiperi, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, shtetas shqiptar, me numer personal I80717117H, i cili do te jete drejtues ligjor i saj, si dhe do te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet me te tretet.
- Krahas ecurise se veprimtarise se shoqerise, une ortaku i vetem i saj do te vendos per zgjerimin e organeve te ndryshme te drejtimit dhe te administrimit ekonomik .
- Per cdo ceshtje profesionale, si juridike, ekonomike, teknike etj, shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkohshme duke punesuar specialiste sipas legjislacionit ne fuqi .

#### Neni 9

#### SIGURIMI I PASURISE SE SHOQERISE

- Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese, apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi .
- Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga une ortaku i vetem i shoqerise.

#### Neni 10

#### LIKUJDIMI I SHOQERISE

- Rastet e likujdimit te Shoqerise si dhe ai i mbarimit te afatit te aktit te Themelimit te Shoqerise, do te jene ato qe pasqyrohen ne legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

#### Neni 11

#### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

- Ky akt per themelimin e Shoqerise ka si pjese te tij edhe Statutin e Shoqerise i cili i bashkengjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
- Ne rastet e likujdimit perfundimtar te Shoqerise, sipas legjislacionit ne fuqi, pushon se vepruari edhe ky Akt – Themelimi.
- Adresa ligjore e shoqerise eshte: Çlirim, Njesia Administrative Qender, Bashkia Fier, Qarku Fier, zona kadastrale nr. 1414, pasuria nr. 38/24-N2.
- Çdo ndryshim apo shtese qe mund ti behet ketij Akti per Themelimin e saj duhet te behet me shkrim, te nenshkruhet nga une ortaku i vetem shoqerise dhe te depozitohet si ne dokumentat e shoqerise qe mbahen ne Qendren e saj, ashtu si edhe ne Q.K.B.

Ky akt themelimi I shoqerise u hartua ne kater kopje te barabarta dhe u nenshkrua nga une ortaku i vetem i shoqerise, me vullnet te lire dhe te plote.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**GALEMIR META**

**ADMINISTRATORI  
MIGUEL VRENOZI**

